

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Platforma për aplikimet online për rregjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): • Shërbimet e zhvillimit të softëareve 72262000-9, • Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit 72267100-0.

VLERA E FONDIT LIMIT: 24.686.667 (njëzet e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh, me objekt: "Platforma për aplikimet online për rregjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe", vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të V.K.B-së Nr. 126 dt 23.12.2022 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023" i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:

1. **"Platforma për aplikimet online për rregjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe",** në programin buxhetor "Investim (231)" me tipologji **"Sistem software"** me vlerë të fondit limit 19.100.000 (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind mijë) lekë pa tvsh.
2. **"Platforma për aplikimet online për rregjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe",** në programin buxhetor "Shpenzime operative (602)" me tipologji **"mirëmbajtje + trajnim"** me vlerë të fondit limit 5.586.667 (pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Shënim: Referuar rekomandimit nr. 6911 prot., datë 28.10.2020 të APP-së, vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të mirëmbajtjes të ofruara nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra, pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit dhe si e tillë, nuk mund të kualifikohet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe shtojcës 9 të DST-së.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet përkatësisht 24.686.667 (njëzet e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas

kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me:

a) Standardin ISO 9001 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas

zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

b) Standardin ISO 27001 ose ekuivalente (e përditësuar) për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

c) Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me standardin ISO 20000-1 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi 2.3.2/a, 2.3.2/b dhe 2.3.2/c:

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Kërkesa për Standardin ISO 9001 ose ekuivalente

Certifikata e standardit të cilësisë ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë se kompanive të të gjithë sektorëve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi të kontratës objekt prokurimi, sipas standardeve ndërkombëtare.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë, siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij. Nisur nga proceset e punës kritike, rëndësisë së sistemit dhe shërbimeve që ai ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik, proceset e punës së tij, ti bazojë në standarte botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtësi, dhe efikasitet të shërbimeve të ofruara.

Për sa më sipër, kërkesa për ISO 9001 (ose ekuivalente) është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.

Kërkesa për Standardin ISO 27001 ose ekuivalente

ISO 27001 është një standard ndërkombëtar për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe ofron një standard të qartë të politikave dhe procedurave që organizatat duhet të ndjekin për të siguruar të dhënat e tyre dhe për të parandaluar humbje të të dhënave ose shkelje të sigurisë. Çertifikimi sipas kërkesave të kriterit i siguron AK mbrojtjen e të dhënave, identifikimin e rrisqeve të sigurisë dhe në ndërmarrjen e masave për t'i parandaluar ato. Çertifikata e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001 ose ekuivalente, është e nevojshme, për shkak të rëndësisë së veçantë që ka sistemi informatik objekt prokurimi, aq më tepër që sistemi do të duhet të ndërveprojë me sisteme të tjera shtetërore dhe i siguron AK, mbrojtjen e të dhënave, identifikimin e rrisqeve të sigurisë dhe në ndërmarrjen e masave për t'i parandaluar ato. Kjo përfshin hartimin e politikave, procedurave dhe masave teknike që ndihmojnë në parandalimin e shkeljeve të sigurisë dhe incidenteve të mundshme. Rrjedhimisht ISO 27001 (ose ekuivalente) është e nevojshme për AK për sigurinë dhe të dhënat dhe krijon besueshmëri në implementimin e kontratës.

Kërkesa për standardin ISO 20000-1 ose ekuivalente

Sistemi i menaxhimit të shërbimit është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

Standardi ISO 20000-1 përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

Sistemi i menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre. Kërkesat përfshijnë projektimin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve për të përmbushur kërkesat e dakorduara të shërbimit, nepermjet sigurise së nevojshme për ecurine e punes se AK. Projekti “Platforma për aplikimet online për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe” kërkon planifikim, (sipas termave të referencës “Faza përgatitore për sistemin/platformën), zhvillim, integrim, testim të sistemit, trajnim të stafit si dhe mirëmbajtje përgjatë 24 (njëzet e katër) muajve, konkretisht sipas fazave të përcaktuara në dokumentin e termave të referencës:

Faza I –Faza përgatitore për sistemin/platformën

Faza II – Faza e zhvillimit të sistemit / platformës

Faza III – Faza e integritit dhe testimit të sistemit/platformës

Faza IV –Trajnimi i përdoruesve

Faza VI- Dorëzimi Përfundimtar/ Marrja në dorëzim

Faza VII – Mirëmbajtje e sistemit

Pra, projekti kërkon realizim brenda një periudhe kohore të parapërcaktuar, relativisht të shkurtër dhe shërbime intensive që duhen të jenë detajisht të monitoruara. Ky standard/çertifikatë ose ekuivalente e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që do të realizohen përgjatë kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

2.3.3 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 4 (katër) punonjës të diplomuar në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/ Informatikë Ekonomike/Mekatronike/Telekomunikacion, si dhe staf të certifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të Çertifikuar për Menaxhim Projekti (PMP ose ekuivalent) për një menaxhim sa më të mirë e efikas të projektit.
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të Çertifikuar për Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent).
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të Çertifikuar si Auditor i Sistemeve të Informacionit (CISA ose ekuivalente).
- d) Të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar si testues sistemesh.
- e) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për programim/zhvillim sistemi në teknologjinë me të cilën do ndërtohet sistemi objekt kontrate (ose ekuivalente).

***Shënim 1: Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.**

***Shënim 2 : Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.**

Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit të punonjësve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues, si më poshtë:

- Certifikata për specialistët e kërkuar
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të stafit të angazhuar (emër mbiemër), profilin e tyre (cerifikimin, diplomimin), citimin e dokumentacionit provues të kërkuar për secilin prej tyre.
- Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi ku të përfshihet stafi si më sipër.

Kriteri 2.3.3 dhe nënkomponentët e tij pika a ,b, c,d,e do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi 2.3.3:

Kërkesa për staf sipas këkresave të kriterit 2.3.3 është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4, ku citohet:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

Fushat e përmendura të diplomimit sipas kërkesave të kriterit 2.3.3 janë pjesë e fushave të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, sikurse është dhe i fokusuar tërësisht projekti objekt prokurimi. Punonjësit e diplomuar në këto fusha dëshmojnë kanë njohuri dhe ekspertizë teknike, aftësi për të përdorur teknologjitë e reja dhe për të sjellë inovacion në implementimin e platformës, të cilat janë të rëndësishme për ndërtimin,

zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit informatik. Përgjithësisht, kjo kërkesë për personel të diplomuar në fusha teknologjike ka për qëllim sigurimin e një ekipi me njohuri të thella dhe aftësi të specializuara për të siguruar suksesin e implementimit të platformës dhe për të përmirësuar performancën dhe sigurinë e saj në të ardhmen. Me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet realizimi i bërjes aktiv të shërbimit brenda afateve kohore të specifikuar në termat e referencës së kësaj procedure si dhe realizimi i shërbimit të vazhdueshëm të mirëmbajtjes, ku është e domosdoshme të parashikohen dhe rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime etj).

Argumentimi 2.3.3/a

Për mirë-menaxhimin e kontratës dhe sigurinë që të përmbushen detyrimet kontraktuale, është e domosdoshme prezenca e një menaxheri projektsh të certifikuar.

Kjo kërkesë garanton që Operatori Ekonomik do të angazhojë specialistë të certifikuar për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave më të mira botërore duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe kompleksitetin e projektit. Një punonjës i certifikuar si menaxher projekti siguron që kontrata të jetë e suksesshme duke koordinuar dhe menaxhuar të gjitha aspektet në përmbushje të qëllimit të kontratës dhe menaxhim të sinkronizuar të të gjitha fazave si analiza e përgjithshme, zhvillimi, testimi, integrimi, trajnimi dhe mirëmbajtja e platformës.

Menaxheri i projektit duhet të njihet me ToRS të kësaj procedure prokurimi, të cilin do e menaxhojë sipas fazave përkatëse, do realizojë monitorim dhe raportim përgjatë shtrirjes së kontratës, i cili do të garantojë zbatimin dhe realizimin me sukses të projektit në kohë me cilësi dhe sipas standardeve ndërkombëtare.

Argumenti 2.3.3/b

1 (një) punonjës i certifikuar si CISM (Certified Information Security Manager) ose ekuivalent, vërteton se operatori ekonomik ka në stafin e tij punonjës të aftë për dizenjimin, zbatimin dhe menaxhimin e sigurisë.

Një punonjës i certifikuar si CISM (Certified Information Security Manager), është i aftë për:

1. **Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit:** Gjatë implementimit të sistemi objekt kontrate, është e rëndësishme të kenë një menaxher të certifikuar CISM ose ekuivalent që do të koordinojë dhe menaxhojë të gjitha aspektet e sigurisë së informacionit, marrë parasysh që në sistem do të trajtohen të dhëna sensitive dhe personale të aplikantëve.

2. **Planifikimin e Sigurisë:** Përpara implementimit të platformës, është e rëndësishme të përgatitja një plan mbi sigurinë e informacionit. Një punonjës i certifikuar në menaxhimin e sistemeve të sigurisë ofron njohuri rreth hartimit të politikave dhe strategjive të sigurisë, ndihmon në identifikimin e risqeve potenciale, dhe siguron që të gjitha aspektet e sigurisë janë të përfshira në planifikim.

3. **Identifikimin e Rreziqeve dhe Menaxhimin:** Përfshin njohuri rreth identifikimit dhe menaxhimit të risqeve të sigurisë së informacionit. Gjatë fazës së implementimit, mund të hasen sfida dhe risqe të ndryshme që kërkojnë një qasje të strukturuar për t'i adresuar.

4. **Kontrollin e Proceseve:** Në fushën e sigurisë së informacionit, është e rëndësishme të sigurohen që proceset janë të sigurta.

5. **Ruajtjen e Integritetit dhe Konfidencialitetit:** Gjatë implementimit të një sistemi informatik, është e rëndësishme të sigurohet integriteti dhe konfidencialiteti i të dhënave dhe informacionit. Duke marrë parasysh që: platforma do të jetë e hapur për publikun; do të ngarkohen dokumenta me përmbajtje të dhënash personale, do të ndërveprojë me sisteme të tjera e-gov, ruajtja e integritetit dhe konfidencialitetit të dhënave elemente shumë të rëndësishëm në këtë kontratë.

6. **Ligjshmëria dhe Rregullatorët:** Një punonjës i certifikuar në menaxhimin e sistemeve të sigurisë ka njohuri rreth legjislacionit dhe rregullave të aplikueshme në fushën e sigurisë së informacionit. Është e rëndësishme të sigurohet që implementimi i sistemit është në përputhje me të gjitha rregullat dhe kërkesat ligjore.

Një punonjës i certifikuar CISM ose ekuivalent ka njohuri dhe përvojë në fushën e sigurisë së informacionit, ky person do të jetë në gjendje të udhëheqë dhe të sigurojë që implementimi i sistemit të jetë i sigurt dhe i përputhshëm me standardet e sigurisë së informacionit. Kjo mund të jenë kritike për ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe për përmbushjen e qëllimeve të sigurisë.

Për sa më sipër, bazuar në kompleksitetin e procedurës, është e nevojshme dhe e rëndësishme prania e një menaxheri të sigurisë së informacionit i cili të mund të hartojë dhe dizenjojë një plan të mirëdetajuar të zhvillimit të të gjithë detyrave të kërkuara duke mbajtur në konsideratë menaxhimin e incidenteve nëse do të

ketë dhe menaxhimin e riskut të informacionit.

Argumentimi 2.3.3/ c

Certifikimi CISA është një standard i njohur globalisht për vlerësimin e njohurive, ekspertizës dhe aftësive të një auditori të IT-së në vlerësimin e dobësive dhe vendosjen e kontrolleve të IT-së në një organizatë/ Institucion. Auditimi i Sistemeve të Informacionit (CISA): CISA është i përqendruar në auditimin e sistemeve të informacionit dhe proceseve të tyre. Punonjësit e certifikuar në CISA janë të përgjegjshëm për vlerësimin e sistemeve të informacionit dhe identifikimin e dobësive ose rreziqeve të sigurisë.

1 (një) punonjës të Certifikuar si Auditor i Sistemeve të Informacionit ose ekuivalente siguron njohuri dhe aftësi në auditimin e sistemeve të informacionit. Kjo mund të ndihmojë në identifikimin e dobësive dhe risqeve të mundshme në platformë, duke përfshirë sigurinë dhe cilësinë e të dhënave.

Certifikimi CISA ose ekuivalent, garanton Autoritetin Kontraktor që OE zotëron njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për realizimin e detyrave të kërkuara si auditimin e procedurave, rregulloreve, mënyrën e administrimit të sigurt të teknologjisë së informacionit në përputhje me standardet ndërkombëtare të Sigurisë së Informacionit, objekt kontrate si dhe principet e auditimit të sistemeve të informacionit. Nëpërmjet këtij kriteri, në kontekstin e objektit të prokurimit, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantojë cilësinë e procesit të auditimit të sistemeve si dhe besueshmërinë e rekomandimeve që do t'i lihen AK, në fund të proceseve përkatëse. Për sa më sipër, ky certifikim garanton AK se OE ka në stafin e tij punonjës të kualifikuar.

Që një sistem të jetë i qëndrueshëm dhe i përputhshëm me standardet dhe rregulloret, është e rëndësishme një qasje e integruar që përfshin të koordinuar menaxhimin e sigurisë dhe auditimin e sistemit.

Njohuritë dhe aftësitë e fituara përmes këtyre certifikimeve mund të ndihmojnë në identifikimin e rreziqeve, parandalimin e problemeve dhe sigurimin që sistemi objekt kontrate të punojë në mënyrë efikase dhe të sigurtë.

Për rrjedhojë, kombinimi i CISM ose ekuivalente dhe CISA ose ekuivalente, mund të sigurojë një qasje të plotë për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe auditimin e sistemeve të informacionit gjatë zhvillimit të një sistemi të suksesshëm dhe të sigurt.

Argumentimi 2.3.3/d

Ky kriter është garanci për Autoritetin Kontraktor që zhvillimi i testeve së sistemeve të informacionit të realizohet në kohë me cilësi dhe sipas standardeve në fushë duke garantuar që do të ndiqet një procedurë e standardizuar testimi që është e rregulluar nga norma të mirë-përcaktuara. Një person me një certifikim të përcaktuar në testimin e sistemeve ka njohuri në teknikat e testimit duke siguruar që cdo ndryshim, përshtatje, modifikim, shtim funksionaliteti është në parametrat e duhur teknike dhe funksionale, para se të merret vendimi për të kaluar live. Një punonjës i certifikuar për testimin e sistemeve ndikon direkt në identifikimin e problemeve, përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të proceseve të testimit dhe të përfundimit të një sistemi tërësisht funksional.

Argumentimi 2.3.3 /e

Kompetencat e specialistëve të certifikuar për programim/zhvillim sistemi, lidhen me nivelin e zotërimit të aftësive teknike, ekspertizën dhe njohuritë e nevojshme për të kryer role komplekse për zhvillimet e sistemeve informatike. Kërkesa për 1 (një) punonjës të certifikuar sipas kërkesave të kriterit 2.3.3/e është e lidhur ngushtësisht dhe drejtpërdrejt me sistemin informatik që kërkohet të zhvillohet, objekt kontrate. 1 (një) punonjës i certifikuar i provon AK se Operatori Ekonomik ka në përbërjen e tij staf të aftë në krijimin dhe zhvillimin e sistemeve informatike dhe përmbushjen e detyrave të kërkuara, konkretisht me zërat :

- Implementimin e Platformës për aplikimet online për regjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe
- Periudha e mirëmbajtjes së platformës me komponentët përkatës.

Duke qenë se kërkohet jo vetëm ndërtimi i një platforme por dhe mirëmbajtja e saj, për të garantuar vijueshmërinë e funksioneve dhe mirëmbajtjen e të gjithë komponentëve përbërës, është i nevojshëm dhe i domosdoshëm punonjësi i kërkuar.

Referuar termave të referencës, specifikimeve teknike, natyrës dhe objektit të saj, si dhe shërbimeve të

kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, shfaqet e nevojshme zotërimi i stafit me kompetencat në teknologjinë me të cilën do të ndërtohet sistemi, ose ekuivalente me të.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentim i termave të referencës:

*Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt “**Platforma për aplikimet online për rregjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe**”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Objektivi kryesor i kësaj kontratë është sigurimi i një platforme informatike që do të digjitalizojë procesin për aplikimin, shqyrtimin, përzgjedhjen e fëmijëve për t’u regjistruar në Kopshtet dhe Çerdhet e Bashkisë Tiranë.

Nëpërmjet kësaj kontrate, autoriteti kontraktor synon:

- Digjitalizimin e procesit të aplikimit, shqyrtimit, përzgjedhjes për regjistrim të fëmijëve në kopshte dhe çerdhe nëpërmjet një platforme digjitale të dedikuar, me qëllim standartizimin dhe menaxhimin më profesional dhe më me efikasitet të proceseve të punës.
- Përmirësimin cilësor të zhvillimit të procesit të aplikimit dhe përzgjedhjes së fëmijëve në kopshte dhe çerdhe, nëpërmjet sigurimit të një platforme të përshtatshme të digjitalizuar.
- Automatizim maksimal të proceseve për të patur një zgjidhje finale të një sistemi që përfshin të dhënat mbi objektivat e planifikuara, realizimet dhe të dhënat operacionale përkatëse.
- Përmirësimi i efikasitetit të gjithë procesit dhe dhënies së shërbimit në një kohë sa më të shpejtë për grupet e synuara.
- Transparencë në të gjitha hallkat e përfshira në këtë proces dhe mundësi e evidentimi problematikash për t’i adresuar në kohë.
- Saktësi e informacionit dhe akses në çdo kohë i të dhënave mbi aplikantët.
- Koordinimin dhe lehtësinë në procesin e përzgjedhjes së fëmijëve, nisur nga rastet më me prioritet sipas kriterëve të përzgjedhjes konform legjislacionit në fuqi.

Termet e referencës e specifikimet teknike të këtij shërbimi, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termet e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Platforma për aplikimet online për rregjistrimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit
Termet e referencës

NJËSIA E PROKURIMIT